

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni- sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit K. B. nga Drenasi, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II nr.3151/15 të datës 11.05.2016, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 paragrafi 1 të KP-së, në shqyrtimin fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Beqë Shala dhe të akuzuarit, me datë 01.06.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari:

K. B. nga i ati A. B. dhe e ëma B. C., e vajzërisë H. I, i lindur me nënë fshatin D. E, Komuna e D. F, tani jeton D. G, rr. H. I, nr.25, ka të kryer shkollën e mesme, tregëtar, i martuar, i ati i tre fëmijëve, punëtor, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal J. K.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 22.08.2015, rreth ores 15:20 minuta, përmes telefonit, me fjalë e kanos seriozisht të dëmtuarën Z. A. L. në atë mënyrë që e thërret në telefon duke i kërkuar që të dal jashtë në mënyrë që të del me të dhe se do t'ja jap 50 € dhe pasi që e njëjta nuk pranon të dal jashtë, e kanos me fjalët "dil jashtë se po të vi brenda të ngehi zhag dhe të mbysë", me çrast tek e dëmtuara shkakton frikë, ankth dhe e njëjta seriozisht ndihet e pa sigurt dhe e kanosur.

-Këso dore kryen veprën penale të kanosjes nga neni 185 paragrafi 1 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 46, 73 dhe nenin 185 paragrafi 1 të KP-së, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 200 € (dyqindë e pesëdhjetë euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burgim, përkatësisht dhjetë (10) ditë burgim.

I akuzuari K. B., obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

E dëmtuara Z. A. (R. L. nga D. E, rr. H. I, nr.25, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsy e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II nr.3151/15 të datës 11.05.2016, kundër të akuzuarit K. B. nga D. për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 paragrafi 1 të KP-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilën i akuzuari K. B. ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari K. B. në ditën kritike, me datë 22.08.2015, rreth orës 15:20 minuta, përmes telefonit, me fjalë e kanos seriozisht të dëmtuarën Z. I. në atë mënyrë që e thërret në telefon duke i kërkuar që të dal jashtë në mënyrë që të del me të dhe se do t'ja jap 50 € dhe pasi që e njëjta nuk pranon të dal jashtë, e kanos me fjalët "dil jashtë se po të vi brenda të ngehi zhag dhe të mbysë", me ç'rast tek e dëmtuara shkakton frikë, ankth dhe e njëjta seriozisht ndihet e pa sigurt dhe e kanosur.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari K. B. i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit, kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprat penale të cilat u vihen në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tyre, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se të akuzuarit prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i kanë kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, rrethanat personale të akuzuarit, se është familjar, i ati i tre fëmijëve dhe se në gjykim ka patur qëndrim tejet korrekt para gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedonë i akuzuari.


Vendimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.979/2016, me datë 01.06.2017

Procesmbajtësja
Luljeta Luboteni



Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani



UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakena qur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.